

VENDIM
Nr. 402, datë 19.6.2019

**PËR LEJIMIN E PËRDORIMIT TË BRIGJEVE DHE TË SIPËRFAQES PËRPARA
RESORTIT, NË FUNKSION TË REALIZIMIT TË PROJEKTIT INVESTUES
STRATEGJIK “WHITE ROCKS”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 29, të ligjit nr. 55/2015, “Për investimet strategjike në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lejimin e përdorimit të brigjeve të detit dhe të sipërfaqes përpara resortit për realizimin e projektit investues strategjik “*White Rocks*”, Gjilekë, Dhërmi, Himarë, zona kadastrale 1739, i cili ka përfituar statusin e investitorit strategjik, procedurë e asistuar, me vendimin nr.15/3, datë 4.3.2019, të Komitetit të Investimeve Strategjike (në vijim “KIS”).

2. Afati për përdorimin e brigjeve, sipas këtij vendimi, do të jetë 20 (njëzet) vjet, duke filluar nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

3. Bashkia Himarë ka detyrimin që, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga data e paraqitjes së kërkesës së investitorit strategjik “*Eurocol*” sh.p.k., të lidhë kontratën përkatëse për lejimin e përdorimit të brigjeve të detit, në përputhje me sipërfaqet dhe destinacionin e kërkuar nga subjekti, brenda koordinatave të sipërfaqes së lejuar nga vendimi i KIS-it.

4. Investitori strategjik “*Eurocol*” sh.p.k., duhet të paraqesë, pranë Bashkisë Himarë, kërkesën dhe dokumentacionin, si më poshtë vijon:

a) ekstrakt të 3 (tre) muajve të fundit, lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit;
b) planvendosje të sipërfaqes, për të cilën subjekti kërkon të lidhë kontratë me njësinë e vetëqeverisjes vendore;

c) përshkrim të aktivitetit që do të realizojë në sipërfaqen për të cilën kërkon të lidhë kontratë.

5. Përdorimi i brigjeve do të kryhet përgjatë periudhës së sezonit veror, 15 maj–30 shtator, të çdo viti, përkundrejt pagesës së tarifës, në përputhje me tarifën e plazheve, të përcaktuar në vendimin e Këshillit Bashkiak Himarë. Kjo tarifë do të aplikohet vetëm mbi sipërfaqen objekt kontrate, sipas pikave 3 dhe 4, të këtij vendimi, të lidhur me Bashkinë Himarë, përgjatë periudhës së përmendur në këtë pikë.

6. Të ardhurat e mbledhura nga tarifa për dhënien e së drejtës së përdorimit të brigjeve administrohen dhe bëjnë pjesë në buxhetin e Bashkisë Himarë.

7. E drejta e përdorimit të brigjeve nga ana e investitorit strategjik “*Eurocol*” sh.p.k., me NUIS/NIPT J61810018B, koordinatat, sipërfaqja e lejuar për përdorim afatgjatë dhe kushtet e përdorimit bazohen në vendimin nr.15/3, datë 4.3.2019, të KIS-it, dhe në përputhje me përcaktimet e kontratës përkatëse që investitori strategjik duhet të lidhë me Bashkinë Himarë.

8. Ngarkohet Bashkia Himarë për lidhjen e kontratës përkatëse me investitorin strategjik, në zbatim të këtij vendimi. Në këtë kontratë të parashikohen shprehimisht të drejtat e detyrimit e autoritetit kontraktues dhe të drejtat e detyrimit e investitorit, në funksion të projektit të investimit strategjik, si dhe penalitetet përkatëse.

9. Ngarkohet Bashkia Himarë që, bazuar në vendimin e Komitetit të Investimeve Strategjike, të lidhë kontratë për dhënien me qira të sipërfaqes përpara resortit, me koordinata X=382288,649; Y=4445279,031; X=382253,017; Y=4445265,828; X=382338,982; Y=4445167,955; X=382370,780; Y=4445184,818; X=382347,882; Y=4445209,940, nën juridiksion të Bashkisë Himarë, sipas legjislacionit në fuqi, me afat për një periudhë 20-vjeçare,

me kusht që investitori të mos ndryshojë destinacionin e pronës (përfshirë, por pa u kufizuar, ndërtimin, dhënien më qira palëve të treta).

10. Ngarkohen Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve dhe Bashkia Himarë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe